VENDIM
Nr. 247, datë 13.12.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA SHTESA NË RREGULLOREN "PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE-s, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16, pika 3 dhe nenit 20, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151 prot., datë 3.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe e Inspektimeve dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, "Mbi fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, të ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, miratoi "Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", të ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 177, datë 8.11.2016.
- Lidhur me këtë Rregullore, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), me shkresën nr. 5393 prot., datë 30.8.2021, ka paraqitur në ERE dy kërkesa për t'u reflektuar në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes".
- ISHTI parashtron në ERE 2 (dy) kërkesa: së pari, përfshirjen në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes" të detyrimit të subjektit që kërkon të pajiset me lidhje të re, për të bërë regjistrimin pranë ISHTI-t përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit), vërtetuar me dokumentin përkatës të lëshuar prej tij; dhe së dyti, në pikën 2.1 të kësaj rregullore, për lidhje të reja në tensionin e ulët (TU), fuqia e instaluar 0–20 kw, të kërkohet nga ana e aplikantit projekti elektrik përkatës.
- Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi për mbikëqyrjen e tregut në industrinë joushqimore, kërkesat e parashtruara nga ISHTI i shërbejnë harmonizimit të legjislacionit në fuqi dhe, konkretisht, mbikëqyrjes dhe monitorimit të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes dhe bazohen në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 10489, datë 15.11.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar; në VKM-në nr. 245, datë 30.3.2016, "Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet dhe instalimet elektrike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"; në VKM-në nr. 482, datë 17.6.2020, "Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV"; si dhe në VKM-në nr. 483, datë. 17.6.2020, "Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 kV".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për disa shtesa në rregulloren "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar.

a) Te pjesa II, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re", për lidhje të reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.6, propozohet të shtohet pika 2.1.7, me përmbajtje: "Vërtetimin e

regjistrimit pranë ISHTI-t përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit) vërtetuar me dokumentin përkatës".

b) Te pjesa II, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re", për lidhje të reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.8, propozohet të shtohet pika 2.1.8, me përmbajtje: "Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë".

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe e Inspektimeve të njoftojë palët e përfshira për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti